

Data 10.09.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “MIRËMBAJTJE SISTEMI CORE BANK”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Shërbime për mirëmbajtjen e sistemit- **50324100-3**

Shërbime për mirëmbajtjen parandaluese të sistemit-**50324200-4**

VLERA E FONDIT LIMIT: **1,797,600** (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin e nevojshëm teknik për realizimin e shërbimit si më poshtë:

- (a) Të paktën 1 (një) programues “Full-Stack” ose 1 (një) zhvillues Front-End dhe 1 (një) zhvillues Back-End në gjuhën e programimit Python ose ekuivalente, i/të diplomuar në Informatikë / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni ose çdo arsim tjetër i ngjashëm
- (b) Të paktën 1 (një) administrator ose zhvillues për bazën e të dhënave (databazë) në SQL (PostgreSQL) ose ekuivalente, i diplomuar në Informatikë / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni ose çdo arsim tjetër i ngjashëm.
- (c) Të paktën 1 (një) specialist për sigurinë e informacionit, i diplomuar në Informatikë / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni ose çdo arsim tjetër i ngjashëm

Për punonjësit të paraqitet:

- Diplomë Universitare në Informatikë/ Inxhinieri Informatikë / Teknologji Informacioni apo cdo arsim tjetër i ngjashëm.
- Kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës;
- Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuara nga organe certifikuese të akredituara.

***Shënim:** Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave, te pakten muajin e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

***Shënim:** Punonjësit e kërkuar në këtë kriter në mënyrë të kombinuar mund të përmbushin një apo disa fusha/kualifikime të kërkuara

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “c”, dhe pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit kërkesat për kualifikim mund të bazohen në aftësinë teknike dhe profesionale dhe autoriteti/enti kontraktor mund të vendosë kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike dhe përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës sipas një standardi të përshtatshëm cilësie, si dhe në mbështetje të nenit 41, pika 2 dhe pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, lidhur me personelin kryesor të nevojshëm për zbatimin e objektit të prokurimit dhe fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e tij, kërkesa për disponimin e punonjësve sipas profileve të përcaktuara është vendosur në funksion të garantimit të kapacitetit teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin me sukses të shërbimit objekt prokurimi.

Mq paraqitet i strukturuar në module funksionale të programuara sikurse evidentohet dhe në specifikime teknike është e domosdoshme mbështetja e tyre nëpërmjet programimit në gjuhën përkatëse drejt zhvillimit, debug, testimit, software. Sistemi ruan dhe përpunon të dhëna të cilat menaxhohen nëpërmjet bazës së të dhënave). Siguria kompjuterike konsiderohet një faktor i rëndësishëm për integritetin e të dhënave duke asistuar pozitivisht në aksesueshmerinë dhe funksionalitetin e sistemit aktual. Referuar për sa më sipër, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë burime njerëzore me ekspertizën përkatëse në këto fusha.

Në këtë kuadër, kërkesa për programues Full-Stack ose zhvillues Front-End dhe Back-End në Python ose teknologji ekuivalente, kërkesa për administrator/zhvillues të bazës së të dhënave në SQL (PostgreSQL) ose ekuivalente dhe specialist të sigurisë së informacionit është drejtpërdrejt e lidhur me shërbimet që do të realizohen dhe synon të garantojë kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për përmbushjen me cilësi dhe në mënyrë të sigurt të detyrimeve kontraktore.

Kriteri është hartuar duke respektuar **parimin e proporcionalitetit**, pasi numri dhe profili i personelit të kërkuar lidhen me nevojat konkrete të realizimit të objektit të kontratës dhe nuk tejkalojnë atë që është e nevojshme për garantimin e realizimit të shërbimit.

Në mënyrë të veçantë, parashikimi që kërkesa mund të përmbushet nga 1 (një) programues Full-Stack ose nga 1 (një) zhvillues Front-End dhe 1 (një) zhvillues Back-End, si dhe parashikimi që punonjësit e kërkuar mund të përmbushin në mënyrë të kombinuar një apo disa nga

fushat/kualifikimet e kërkuara, synon të shmangë kufizimin e panevojshëm të konkurrencës dhe t'u japë operatorëve ekonomikë fleksibilitet në organizimin e burimeve të tyre njerëzore, duke garantuar njëkohësisht që të gjitha kompetencat teknike të nevojshme të jenë të mbuluara.

Kërkesa për arsim universitar në Informatikë, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni ose fusha të ngjashme justifikohet nga natyra e specializuar e detyrave që do të kryhen dhe synon të sigurojë që personeli i angazhuar të ketë bazën e nevojshme akademike për realizimin e tyre.

Gjithashtu, kërkesa që personeli të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik, e vërtetuar nëpërmjet formularit përkatës të E-SIG/listëpagesave për periudhën e përcaktuar në Dokumentet e Tenderit, është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet se operatori ekonomik disponon realisht burimet njerëzore të deklaruara dhe se këto burime janë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2 është **i nevojshëm, objektiv, i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe proporcional me kërkesat e saj**, pasi synon të garantojë disponimin e kapaciteteve të mjaftueshme teknike dhe profesionale për realizimin e suksesshëm të shërbimit, duke respektuar njëkohësisht parimet e konkurrencës, trajtimit të barabartë, transparencës dhe proporcionalitetit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.

Për këto arsye, kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2 konsiderohet i justifikuar dhe i domosdoshëm për vlerësimin e kapacitetit teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë që do të marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga DPA ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH/ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, si dhe të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, sipas të cilit Autoriteti/Enti Kontraktor mund të përcaktojë, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, kritere të tjera të veçanta në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, është përcaktuar kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë deklaratë me anë të së cilës merr përsipër instalimin, montimin, shërbimin e skanimit, konfigurimin, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemit, si dhe trajnimin e stafit.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë certifikimin SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme është përcaktuar me qëllim

garantimin e një niveli të qëndrueshëm dhe të kontrollueshëm të cilësisë në ofrimin e shërbimit objekt prokurimi. Duke qenë se kontrata ka për objekt mirëmbajtje sistemi core bank shërbimi kërkon administrim dhe kontroll të vazhdueshëm të proceseve, menaxhim të problematikave teknike dhe sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit gjatë gjithë periudhës kontraktore. Certifikimi shërben si tregues i ekzistencës së një sistemi të standardizuar të menaxhimit të cilësisë dhe të proceseve të dokumentuara për kontrollin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit. Në këto kushte, kërkesa për certifikimin ISO 9001 justifikohet nga nevoja për të garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitetet organizative, procedurat dhe mekanizmat e kontrollit të nevojshëm për ofrimin e qëndrueshëm, të kontrolluar dhe cilësor të shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit Core Banking.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë certifikim SSH/ISO/IEC 27001 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, ose standard ekuivalent/të barasvlefshëm, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën kritike të informacionit dhe të dhënave të përpunuara në kuadër të mirëmbajtjes së sistemit Core Banking, si dhe nevojën për të garantuar një nivel të përshtatshëm të sigurisë së informacionit gjatë gjithë periudhës së kontratës. Operatori ekonomik mund të ketë akses, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në sisteme, konfigurime, databaza, kredenciale teknike ose informacion tjetër që lidhet me funksionimin e sistemit. Për këtë arsye, ekziston nevoja që operatori ekonomik të disponojë një sistem të formalizuar të menaxhimit të sigurisë së informacionit, i cili adreson në mënyrë sistematike rreziqet që lidhen me aksesin, përpunimin, ruajtjen, transmetimin dhe administrimin e informacionit.

Certifikimi SSH/ISO/IEC 27001 shërben si dëshmi se operatori ekonomik ka vendosur dhe mirëmban një kuadër të strukturuar për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit, përcaktimin dhe zbatimin e masave të kontrollit, monitorimin e tyre dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit.

Kjo kërkesë është veçanërisht e rëndësishme për një shërbim të mirëmbajtjes së sistemit Core Banking, pasi cenimi i konfidencialitetit, integritetit ose disponueshmërisë së informacionit dhe sistemeve mund të sjellë pasoja të rëndësishme operative, financiare dhe reputacionale për institucionin.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të përmbushë të gjitha kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Argumentim: Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë deklaratë për marrjen përsipër të përmbushjes së të gjitha kërkesave dhe specifikimeve teknike është përcaktuar me qëllim garantimin që ofertuesi i ka marrë në shqyrtim dhe angazhohet të respektojë të gjitha kërkesat teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit gjatë realizimit të kontratës.

Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcionale dhe synon të sigurojë qartësi dhe përgjegjshmëri të operatorit ekonomik për përmbushjen e detyrimeve teknike dhe kontraktore

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike për procedurën e prokurimit me objekt “**Mirëmbajtje Sistemi Core Bank**” janë hartuar dhe përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, AGROKREDIT SH.A, në funksion të nevojave konkrete të institucionit dhe të kërkesave që lidhen me realizimin e objektit të prokurimit. Dokumentacioni përkatës është përcjellë pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara me shkresën nr. 1481/8 prot., datë 17.08.2026, protokolluar me nr. 3913/3 prot., datë 18.08.2026.

Për rrjedhojë, specifikimet teknike që do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e procedurës janë ato të përcaktuara dhe të përcjella nga Autoriteti Kontraktor nëpërmjet shkresave të sipërcituara, duke reflektuar kërkesat teknike dhe funksionale të nevojshme për realizimin e shërbimit objekt prokurimi.

NJËSIA E PROKURIMIT